



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Datë: 18.06.2025

PROCESVERBAL

Takimi I (i parë) Publik me qytetarë për punën gjashtëmujore të
Kryetarit dhe ekzekutivit lokal
I mbajtur më 13.06.2025 (e premte)
VENDI: Salla e Asamblesë Komunale – Dragash

Njoftimi për këtë Takim Publik është publikuar më 27.05.2025:

Në uebfaqe zyrtare të Komunës:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/02-Nr.Br.020/01-10195/25-18.06.2025-Dragash-Dragaš.pdf>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/02-Nr.Br.020/01-10195/25-18.06.2025-Dragash-Dragaš.pdf>

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
Komuna e Dragashit
Opština Dragaš

Në Facebook-un zyrtar më 28.05.2025:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/16cs1GUV1S/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1H2CaMjYYL2/>

02 Nr. Br. 020/01-10195/25
18.06.2025
Dragash - Dragaš

Pjesëmarrës në këtë takim kanë qenë gjithsej 32 persona, të cilët janë nënshkruar në Listën e pjesëmarrësve. Prej tyre kanë qenë:

1. Femra: 9
2. Meshkuj: 23

Takimin e kryesoi Kryetari i Komunës së Dragashit, Bexhet Xheladini.

Bexhet Xheladini: Të nderuar qytetarë të Komunës së Dragashit! Kam nderin që në emrin tim si kryetar i Komunës dhe në emër të Qeverisë Komunale, t'ju falënderoj për pjesëmarrjen tuaj në debatin e parë publik lidhur me raportin gjashtëmujor të punës së kryetarit të Komunës dhe Qeverisë Komunale! Siç e dini ju, bazuar në Statutin e Komunës, bazuar në Ligjin mbi Menaxhimin e Financave dhe Pushtetit Lokal, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, kryetari i Komunës është i obliguar që dy herë në vit të mbaj debat publik me qytetarë për punën e tij. Sot e kemi Raportin gjashtëmujor të punës së kryetarit. Pa humbur kohë, më lejon që të fillojmë për këtë pikë të rendit të ditës:

Të nderuar të pranishëm,

Ju falënderoj që keni gjetur kohë për të marrë pjesë në Takimin e Parë Publik të organizuar me qytetarë. Siç e dini, ne si Komunë jemi të obliguar ligjërisht që brenda një viti t'i mbajmë së paku dy takime publike me qytetarë, ku në pika të përgjithshme mund të raportojmë për ecurinë e punës së organeve të Ekzekutivit lokal dhe kryetarit të Komunës.

Andaj, kam nderin dhe kënaqësinë që para jush të paraqes një pasqyrë të shkurtër për ecurinë e punëve dhe angazhimet që ka pasur Komuna e Dragashit gjatë këtij gjashtëmujori të parë të vitit 2025.

Si rezultat i punës së përbashkët dhe bashkëpunimit të mirë brenda dhe jashtë institucionit, kemi arritur që shumicën e punëve dhe projekteve t'i realizojmë në bazë të Planit të paraparë të Punës.

Puna e Kryetarit, përkatësisht ekzekutivit të Komunës së Dragashit është zhvilluar përmes 8 drejtorive dhe shërbimeve përcjellëse të Komunës, në harmoni me legjislacionin, udhëzimet dhe Statutin e Komunës.

Synimet tona shumë herë i kemi përmendur dhe nuk dua t'ju humbi kohë. Do të kaloj menjëherë me raportin e punës sonë. Do të vazhdoj me aktivitetet tona:

- Edhe përgjatë këtij viti, kemi vazhduar bashkëpunimin e ngushtë me institucionet dhe përfaqësitë diplomatike ndërkombëtare. Kemi pritur për një vizitë me rëndësi ambasadorin e Britanisë së Madhe, Jonathan Hargreaves;
- Gjithashtu, kemi pritur edhe ambasadorin e Republikës së Turqisë, Sabri Tunç Angili;
- Kemi pasur takim edhe me komandantin e KFOR-it nga Komanda Rajonale Perëndim, Kolonel Francesco Errico, me të cilin kemi diskutuar lidhur me situatën e sigurisë dhe çështje që prekin interesin e përgjithshëm të qytetarëve;

- Kemi zhvilluar takime dhe kemi formalizuar Marrëveshjen me Projektin HELVETAS/DEMOS, për bashkëpunimin dhe konsultimin lidhur me organizimin e takimeve buxhetore dhe rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje;
- Nën organizimin e Ministrisë së Infrastrukturës dhe Institutit për Planifikim Hapësinor, kemi marrë pjesë në takimin publik lidhur me shqyrtimin e Draftplanit Hapësinor të Parkut Kombëtar Sharri dhe Draftraportit të Vlerësimit Strategjik Mjedisor për Planin Hapësinor në Parkun Kombëtar Sharri, ku kemi paraqitur kërkesat tona dhe të qytetarëve, të cilat kanë të bëjnë me rritjen e mundësive për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik dhe turistik të Komunës sonë;
- Në fushën e përfaqësimit gjinor në institucionet publike, këtë vit kemi shënuar edhe një hap tutje, ku kemi emëruar edhe dy gra në pozita udhëheqëse: zëvendës drejtoreshën e QKMF-së, e cila për më tepër është edhe nga komuniteti joshumicë, si dhe drejtoreshën e Çerdhes në Dragash;
- Në bashkëpunim me partnerët tanë, kemi filluar edhe realizimin e Projektit të Papa Testit pa pagesë për të gjitha gratë e Komunës sonë, një iniciativë kejo e Grupit të Grave Asambleiste. Ky përbën një hap të rëndësishëm në drejtim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore;
- Në këtë drejtim, gjithashtu kemi filluar edhe programin e vizitave sistematike shëndetësore nëpër shkollat e Komunës së Dragashit, për nxënësit e klasave të para dhe të pesta, një program i realizuar me sukses nga profesionistët tanë shëndetësorë;
- Në kuadër të vizitës studimore të realizuar nga Asambleja Komunale, si kryetar i Komunës, së bashku me Kryesuesen e Kuvendit kam realizuar një takim me kryetarin e Komunës Purkersdorf të Austrisë, me të cilin jemi dakorduar që të thellojmë bashkëpunimin ndërmjet komunave tona, me theks të veçantë në binjakëzimin ndërmjet komunave;
- Për këtë qëllim, ne kemi kaluar procedurat fillestare në Kuvendin e Komunës, ku delegatët me shumicë votash kanë votuar për nisjen e procedurave të binjakëzimit;
- Gjithashtu, Komuna e Dragashit tashmë edhe zyrtarisht është binjakëzuar edhe me Komunën e Mavrovë-Rostushës nga Maqedonia e Veriut, gjatë ceremonisë e cila u zhvillua ditën e djeshme, pra me rastin e Ditës së Çlirimit të Dragashit;
- Me partnerët nga HELVETAS/DEMOS kemi finalizuar nënshkrimin e Marrëveshjes për Mbështetje Financiare të projektit "Asfaltimi i rrugëve dhe kubëzimi i rrugëve në regjionin e Gorës në Dragash (fshatrat Restelicë dhe Radeshtë)", nga Skema e Grantit për Performancë Komunale, projekti kap shumën prej 126,738.95 €, prej të cilave 124,738.95 € do t'i financojë DEMOS, ndërsa Komuna e Dragashit do të participojë me 2,000.00 €;

- Kemi pasur edhe një vizitë me rëndësi nga Përfaqësuesja Speciale e Sekretariatit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, znj.Caroline Ziadeh, ku kemi diskutuar për bashkëpunim e ndërsjellë dhe mbështetjen e ofruar nga UNMIK-u, veçanërisht në zbatimin e projekteve, siç janë Papa Testi dhe përmirësimi i shërbimeve dentare në QKMF, me theks të veçantë për personat me nevoja të veçanta;
- Kemi nënshkruar Marrëveshjen e Bashkëpunimit për Kryerjen e Shërbimeve Postare ndërmjet Komunës së Dragashit, Policisë së Kosovës dhe Postës së Kosovës;
- Gjithashtu, kemi pasur nderin që t'i presim në një takim miqësor përfaqësuesit e organizatave të dala nga lufta, me të cilët kemi pasur një bashkëbisedim të frytshëm rreth ecurisë së bashkëpunimit dhe mbështetjes që Komuna jonë në vazhdimësi ka ofruar për OVL-në e UÇK-së në Dragash;
- Kemi pasur takime edhe me përfaqësues të fshatrave dhe institucioneve shëndetësore nga fshatrat kufitarë të Shqipërisë, si Zapodi, Pakishta etj., me të cilët kemi diskutuar lidhur me shërbimet shëndetësore falas dhe trajtimin e barabartë që Komuna E Dragashit ua bën qytetarëve nga Shqipëria;
- Së bashku me kryesuesen e Kuvendit, kemi zhvilluar një vizitë tek humanisti Halil Kastrati, ku kemi folur rreth mundësisë së thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Komunës së Dragashit dhe shoqatës "Jetimat e Ballkanit" të cilën e drejton humanisti Halil Kastrati. Ky bashkëpunim do të fokusohet në mbështetjen e ofruar për qytetarët e Komunës sonë, me theks të veçantë në ndërtimin e shtëpive të banimit për njerëzit në nevojë, ku shoqata "Jetimat e Ballkanit" dhe Komuna e Dragashit do të jenë bashkëfinancuese;
- Me Ministrinë e Zhvillimi Rajonal kemi vazhduar bashkëpunimin, ku gjatë këtij muaji kemi pritur në takim ministrin e MZbR-së, z.Fikrim Damka, me të cilin kemi diskutuar lidhur me thellimin e bashkëpunimit, konkretisht në mbështetjen financiare që MZbR-ja do të na ofrojë në realizimin e disa projekteve kapitale;
- Në fillim të këtij viti kemi marrë edhe një vendim të rëndësishëm: Komuna e Dragashit ka marrë përsipër pagesën e shpenzimeve të ndriçimit publik për të gjitha fshatrat të cilat e kanë të instaluar ndriçimin;
- Gjithashtu, kemi bërë edhe përrurimin e rrjetit të ndriçimit publik në fshatrat Brrut dhe Pllavë.
- Si qeverisje lokale, kemi marrë pjesë në të gjitha manifestimet për ditët e shkollave në të gjitha shkollat fillore dhe në Shkollën e Mesme "Ruzhdi Berisha";
- Përmes thirrjeve publike në fushën e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kemi subvencionuar **mbi 20 OJQ** me një vlerë totale **149 mijë euro**, për organizimin e aktiviteteve të ndryshme kulturore, sportive dhe rinore.

<i>KLUBI I KUAJVE "OPOJA"</i>	<i>6.000€</i>
<i>KLUBI I SHAHUT "SHARRI"</i>	<i>4.000€</i>
<i>SHKOLLA E FUTBOLLIT "FC DRAGASH"</i>	<i>6.000€</i>
<i>SHKOLLA E FUTBOLLIT "AROMA"</i>	<i>4.500€</i>
<i>KLUBI I FUTBOLLIT "OPOJA"</i>	<i>21.500€</i>
<i>KLUB SPORT "SHARRI"</i>	<i>4.500€</i>
<i>KLUBI I SKITARISË "ARXHENA"</i>	<i>2.000€</i>
<i>KLUBI I MOTORRISTËVE "ENDURO SHARRI"</i>	<i>5.500€</i>

KLUBI I ÇIKLIZMIT "OPOJA"	1.500€
KLUBI I BASKETBOLLIT "SHARRI"	1.000€
NVO"INTER KLUB SPORT" RETELICË	4.500€
SHKA "OPOJA" BUQE	6.000€
NVO"EMKACBEND"- RETELICË	4.000€
DFD"BISER" RETELICË	3.000€
OJQ"QENDRA" DRAGASH	4.000€
NVO"MILJINA" BROD	3.000€
NVO"STARS" RADESHË	5.000€
NVO"DEMOKRATSKA OMLADINA GORA" DRAGASH	5.000€
SHKA"BRESANA" BRESANË	34.000€
SHAKA"BRESANA" BRESANË	11.000€
OJQ"AVOKO"	9.000€

Në fushën e infrastrukturës dhe investimeve kapitale, unë po i përmendi disa projekte të cilat janë përfunduar, janë në proces dhe ato të cilat janë në tenderim, do t'ia lexoje dhe datën kur hapet tenderi:

1.	Ndërtimi i impiantit për ujrat e zeza në rrugën e Mullinit në fshatin Brezne	Veç ka filluar dhe do të kushtojë 300 mijë euro
2.	Rehabilitimi i ngrohjes në shkollën "ULINA" në Kosavë	Ka përfunduar
3.	Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Mlik	Është në procedurë e sipër
4.	Ndërtimi i ndriqimit publik në qendrën e fshatit Gllaboçicë	Ka përfunduar
5.	Ndërtimi i shtëpisë turistike te vendi i quajtur Rudina në fshatin Brod	Tenderi është hapur dhe është në proces
6.	Ndriqimi publik në qendër të fshatit Brrut	Ka përfunduar
7.	Renovimi i objektit të OVL-UÇK-së	Është në procedurë
8.	Renovimi i koridorit dhe shkallëve në objektin e QKMF-së Dragash dhe lysterja e objektit të Hendikosit	Është në procedurë
9.	Ndërtimi i kanalizimit dhe ujësjellësit në qendër të fshatit Kapre	Është në procedurë
10.	Renovimi dhe furnizimi me material për Shtëpinë malore- Bresanë	Ka përfunduar
11.	Ndriçimi publik në qendër të fshatit Pllavë	Ka përfunduar
12.	Furnizimi me material pastrami-Higjienik në QKMF-Komuna e Dragashit	Ka përfunduar
13.	Mirëmbajtja dhe Furnizimi me Inventar i qerdhës në Dragash	Është në procedurë
14.	Riparimi i rrugës në pjesën e dëmtuar në fshatin Pllajnik	Ka përfunduar
15.	Ndërtimi i shtëpise turistike te vendi I quajtur SHTAVA (mahalla e poshtme) dhe parkut te xhamija ne fshatin Blaç	Është në procedurë
16.	Rehabilitimi I ujësjellësve,kanalizimeve dhe pusetave në teritorin e K.K. Dragashit	Kemi lidhur një marrëveshje trevjeçare me një organizatë të specializuar, ku tani për çdo prishje nuk kemi nevojë të hapim tendere.
17.	Asfaltimi i rrugës dhe ndërtimi i parkingut në rrugën Libevisht-Leshtan në fshatin Leshtan	Projekti ka dështuar, nuk është paraqit asnjë kompani
18.	Ndërtimi i këndit të lojërave, kubëzimi, demolimi i shkollës së vjetër në fshatin Bresanë	Tenderi është hapur, është nënshkruar kontrata, së shpejti fillojnë punimet
19.	Rregullimi i rrugës dhe infrastrukturës përcjellëse në rrugën Qupino në fshatin Brod	Është projekt dyvjeçar, është duke u punuar

20.	Kubëzimi i rrugëve dhe Infrastrukturës përcjellëse në fshatin Shajne	Është hapur tenderi, është në proces nënshkrimi i kontratës
21.	Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i kanalizimit në rrugën Jarilice në fshatin Zlipotok	Është hapur tenderi
22.	-Ndërtimi i trotuarit Dragash - Ura e fshatit Shajne, -Ndërtimi i trotuarit Dragash - fshati Kukajan, -Ndërtimi i murit mbrojtës të varrezat e qytetit, si dhe -Ndërtimi i ndriqimit në rrugën Unazore në Dragash	Këto projekte janë të financuara nga Granti i Performancës, vlera është 135 mijë euro, dhe tenderi hapet më 16.06.2025
23.	Ndërtimi i trotuareve Brodosanë - Zaplluxhe si dhe Brrut - Bellobrad	Tenderi hapet më 16.06.2025
24.	Ndriçimi publik në qendër të fshatit Kuklibeg	Projekti fillon këtë javë dhe besoj që kryhet brenda dy jave
25.	Ndërtimi i ujëmbledhësve në vendin Guri i Gat, te del uji dhe të gurost e Pordardhom në fshatin Kuk	Tenderi hapet më 19.06.2025
26.	Kubëzimi i rrugëve në regjionin e Opojës	Nga Granti i Performancës është 102 mijë euro, tenderi hapet më 19.06.2025
27.	Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i ujësjellësit në rrugën Kajqovce në fshatin Lubovisht	Tenderi hapet më 18.06.2025
28.	Kubëzimi i rrugëve të Brrutit të Vogël nga varrezat deri në fushë në fshatin Brrut	Tenderi është hapur më 10.06.2025, por ka dështuar, nuk është paraqit asnjë kompani me i marrë punimet
29.	Hapja e rrugës kah Likeni dhe fusha si dhe Kubëzimi i rrugës qendër në fshatin Brrut	Është projekt dyvjeçar 82 mijë euro, tenderi hapet më 26.06.2025
30.	Kubëzimi i rrugëve dhe ndërtimi i murit mbrojtës në fshatin Zaplluzhe	Tenderi hapet më 24.06.2025
31.	Kubëzimi i rrugëve, ndërtimi i trotuareve si dhe rregullimi i përrroit në fshatin Vraniç	Tenderi hapet më 25.06.2025
32.	Ndërtimi i ndriqimit public në qendër të fshatit Rrenc	Tenderi hapet më 18.06.2025
33.	Kubëzimi i rrugës në rrugën ULICA në fshatin Zgatar	
34.	Asfaltimi i rrugëve dhe Kubëzimi i rrugëve në Regjionin e Gorës në Dragash (fshatrat Restelicë dhe Radeshë), nga Granti i Performancës - DEMOS	Nga Granti i Performancës, tenderi hapet më 02.07.2025
35.	Ndërtimi i shtegut të ecjes Dragash – Stadiumi i qytetit (Projekt me bashkefinancim nga Ministria e Administratës të Pushtetit Lokal (MAPL) dhe K.K. Dragash)	Tenderi ka përfunduar, së shpejti bëhet përrurimi i kësaj rruge
35.	Kubëzimi i rrugëve në fshatin Pllajnik	
36.	Renovimi (adaptimi) i kabinetit të Mjekësise në SHML” Ruzhdi Berisha”- Dragash	

Unë, sa për fillim, nuk kam tjetër çfarë të shtoj. I paraqita në formë të detajuar të gjitha punimet dhe të gjithë aktivitetet që kemi realizuar unë si kryetar, me stafin komunal. Nëse dikush do me pyet, me e marrë fjalën, mundet lirisht ta marrë fjalën dhe të dalë në foltore. Këtu duhet të prezantoheni me emër dhe mbiemër, kënd përfaqëson dhe nga cili fshat është. A do dikush me e marrë fjalën?

Atëherë, meqenëse nuk kemi ndonjë pyetje?

Zikrija Mehmedoviç, banor i fshatit Baçkë: Përshëndetje të gjithëve, ne si fshati më i vogël dhe më i shpërngulur, kemi pasur shumë projekte që janë realizuar. Unë ju falënderoj për bashkëpunimin me autoritetet komunale, z. Kryetar!

Bexhet Xheladini: Faleminderit, i nderuar! Sa u përket kërkesave dhe propozimeve tuaja, ju lutem që t'i adresoni edhe në Dëgjimin buxhetor ku do të diskutohet për draftin e Kornizës Afatmesme Buxhetore, dhe besojmë se aty do të merrni përgjigje. A ka dikush tjetër që dëshiron të marrë fjalën lidhur me raportin gjashtëmujor të punës së kryetarit dhe ekzekutivit lokal? Nëse nuk ka, atëherë unë ju falënderoj edhe një herë për pjesëmarrjen tuaj!

Linqet e lajmeve për mbajtjen e takimit publik, të publikuara në uebfaqen dhe Facebook-un zyrtar:

Në uebfaqe:

Shqip: <https://dragash.rks-gov.net/news/u-mbajt-takimi-i-i-pare-publik-me-qytetare/>

Boshnjakisht: <https://dragash.rks-gov.net/sr/news/odrzan-je-prvi-javni-sastanak-s-gradjanima/>

Në Facebook:

Shqip: <https://www.facebook.com/share/p/1HLEqrYQucM/>

Boshnjakisht: <https://www.facebook.com/share/p/1BYs38Zq9b/>

SHTOJCË: *Lista e pjesëmarrësve në dëgjim buxhetor dhe fotografitë*



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E DRAGASHIT
DRAGASH MUNICIPALITY-OPŠTINA DRAGAŠ



Data/Datum: 13.06.2025 (13.06.2025)

Vendi/Mesto: Salla e Kuvendit Komunal – Dragash/ Sala Skupštine Opštine - Dragaš

LISTA E PJESËMARRËSVE TAKIMIN I (E PARË) PUBLIK ME
QYTETARË PËR PUNËN E GJASHTËMUJORIT TË PARË TË VITIT
2025

LISTA UÇESNIKA PRVOM JAVNOM SASTANKU SA GRAĐANIMA O
RADU U PRVOJ POLOVINI 2025 GODINE

Nr.	Emri dhe Mbiemri	Vendbanimi	Etnia	M	F	Nënshkrimi
Br.	Ime i Prezime	Prebivalište	Etnička pripadnost	M	Ž	Potpis
1	Isa Bejrami	Shajne	KOSOVA	M		
2	Zahide Ahmeti	Shajne	SHQIPTAR		F	
3	LIHQITA PIRAT	Pleure	shq.		F	
4	Velika Qullesh	Bellobrad	SHQIPTAR		F	
5	Behija Esati	Leštane	Goranka		V	
6	Samiu Misini	Shajne	Shqipebre		F	
7	Leonida Misini	Shajne	Shqiptare		F	
8	Zirrije Mahmuti	Bacina	GOSTAN	M		
9	Ismael Ramadani	KUK	SHQIPTAR	M		
10	IBRAHIM KURBAN	DEMOS	SHQIPTAR	M		
11	SHAGR SKERRA	BRANC	SHQIPTAR	M		
12	AGJOLL GEMAJ	DRAGASH	SHQIPTAR	V		
13	HAZIR BERISHA	ELISE	Shqiptar	M		
14	Dreni Myrteza	Baj	Shqiptar	M		
15	ALIDA	BLAC	SHQIPTAR	M		
16	Rexel Fetahu	KUK	Shqiptar	M		
17	Ferit Krasniqi	Buce	shqiptar	M		
18	Uzun Haxhi	Kistare	Bochar	M		
19	Veton Haxhi	Bellobrad	Shqiptar	M		
20	Branci Bauler	BUCE	SHQIPTAR	V		
21	RAMIRI EMINI	KUK	SHQIPTAR	V		
22	Mimoza Beudani	BUCE	Shqiptare		F	
23	Behar Selmani	KUK	Shqiptar	M		
24	ARDIT KALANASTA	KOSARE	Shqiptar	M		
25	YLLI QPFLASHI	BELLOBRAD	SHQIPTAR	M		
26	VEJIR REXHITI	DRESAN	SHQIPTAR	M		

02 Nr. 020/01-10/95/25
13.06.2025
Dragash - Dragaš

27	FLORENT LUPATI	BEGSANG	SHAIPTAR	V	✓	Ruf
28	Galtima KOSMAY	biene	SHAIPTAR	✓	✓	✓
29	ALYIA HOSSEN	KETTER	BASMEH	✓	✓	✓
30	SILBA BASAM	BROD	BASAM	M		✓
31	AZEM VERNAR	PLAVE	SHAIPTAR	M		✓
32	AMLA ZAIMI	RADIA	GOLAPM		X	✓
33						
34						
35						
36						
37						
38						
39						
40						
41						
42						
43						
44						
45						
46						
47						
48						
49						
50						
51						
52						
53						
54						
55						
56						
57						
58						
59						
60						
61						
62						
63						
64						
65						
66						
67						
68						
69						
70						



